

Bigrafia e Ambasadores Alma Lama

Gjatë periudhës 2016-2019 ishte Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqplotë e Republikës së Kosovës në Itali dhe Ambasadore jo rezidente në Republikën e Maltës dhe San Marinos.

Më herët ka qenë deputete e Kuvendi të Kosovës në legjislaturat e viteve 2011-2014 dhe 2014 – 2016, kur e ndërpreu mandatin për të shkuar në misionin diplomatik.

Lama ka qenë e angazhuar në demokratizimin e shoqërisë në Kosovë, të institucioneve, në çështje të transparencës dhe llogaridhënies, politikës së jashtme, lirisë së mediave, të drejtat e njeriut dhe qeverisjes së mirë.

Ajo është deputetja e parë në historinë e Kuvendit të Kosovës që ka draftuar dhe propozuar një ligj, që është Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, aprovuar në vitin 2013, që është një kontribut i madh përsa i përket lirisë së medias.

Gjithashtu, si deputete inicioi dhe konceptoi monumentin e parë të dedikuar kontributit të grave gjatë luftës, të quajtur “Heroinat”, inaguruar me 12 qershor 2015 dhe është vendosur në qendër të kryeqytetit të Kosovës, Prishtinë.

Lama ka gjithashtu një eksperiencë mbi dhjetëvjeçare në fushën e gazetarisë. Ajo ka punuar për televizionin public RTK në Kosovë dhe Tv shqiptar Top Channel. Gjithashtu ka publikuar shkrime dhe artikuj në media të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si: IWPR, korrespondente e Osservatorio Sui Balcani, United Press International, Washington Times, Transition Online etj.

Zonja Lama ka zhvilluar edhe një numër të madh trajnimesh profesionale dhe të lidershit. Në vitin 2012, u përzgjedh si një nga 50 gratë lidere të ardhshme të botës në programin e financuar nga departamenti i Shtetit Amerikan, Gratë në Shërbimin Publik WPSP.

Në vitin 2018 Ambasadorja Lama u nderua me Çmimin Ndërkombëtar “Liberi di Crescere”, në Itali, për punën dhe kontributin e saj në Kosovë.

Ajo ka lindur në Krujë, është diplomuar në vitin 1999, në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë, Universiteti i Tiranës. Aktualisht është doktorante në Institutin e Studimeve Europiane, pranë Universitetit të Tiranës.